



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VIII**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti**

**Mbledhja nr.03/2021**

**Prishtinë, më 27/28.4.2021, në orën 13:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10**

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ferat Shala, kryetar, Jeta Statovci, nënkryetare e parë, Fidan Jilta, nënkryetare e dytë, Gramoz Agusholli, Driton Hyseni, Mimoza Kusari – Lila, Armend Muja, Uran Ismaili, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Ljubinko Karaxhiq dhe Pal Lekaj, anëtarë.

**Të ftuar:** znj. Artane Rozvanolli, Ministre e Ekonomisë;  
z. Jeton Mehmeti, kryesues i bordit të KOSTT-it;  
z. Isuf Mehmeti, Kosova Thëngjilli Sh.A.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Anyla Beqa – Ministria e Ekonomisë; Mustafë Hasani, Kadri Kadriu dhe Skënder Gjonbalaj – KOSTT; Kaltrina Rexha dhe Donikë Beqiri – INDEP; Violeta Haxholli – KDI; Ferid Pula dhe Besianë Musmurati – GP/PDK; Dorentina Murturi – Kuvendi dhe mediat.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Veton Raci.

**Mbledhjen e kryesoi Ferat Shala, kryetar i komisionit.**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 20.4.2021;
3. Shqyrtimi i kërkesës së NP KOSTT, të ftuar për raportim: ministrja e Ekonomisë, znj. Artane Rizvanolli; bordi dhe kryeshefi ekzekutiv i NP KOSTT;
4. Shqyrtimi i kërkesës së ndërmarrjes “Kosova Thëngjilli SH.A”, të ftuar për raportim: ministrja e Ekonomisë, znj. Artane Rizvanolli; Bordi dhe menaxhmenti i ndërmarrjes “Kosova Thëngjilli SH.A”;
5. Situata aktuale e privatizimit në vend, të ftuar për raportim: Bordi dhe drejtori menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
6. Diskutim lidhur me funksionim e agjencive të pavarura, që i raportojnë komisionit;
7. Të ndryshme.

*Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetari** theksoi se për shkak të seancës plenare që do të mbahet sot, në orën 15:00, propozoi që pika 5 e rendit të ditës: *Situata aktuale e privatizimit në vend*, të shtyhet për ndonjë mbledhje tjetër.

*Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit, andaj rendi i ditës u miratua me ndryshimin që të hiqet pika 5.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.4.2021**

*Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 20.04.2021, u miratua pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi i kërkesës së NP KOSTT, të ftuar për raportim: ministrja e Ekonomisë, znj. Artane Rizvanolli; Bordi dhe kryeshefi ekzekutiv i NP KOSTT**

**Ferat Shala, kryetar i komisionit**, theksoi se në fillim të dëgjojmë përfaqësuesit e KOSTT-it, të prezantojnë kërkesën e tyre, mandej do ta ketë fjalën ministrja dhe vazhdojmë me debatin për problematikën që është në diskutim sot, në komision.

**Jeton Mehmeti, kryesues i Bordit të KOSTT-it**, fillimisht uroi anëtarët e komisionit për zgjedhjen deputetë, si dhe uroi ministren Rizvanolli për detyrën e re, si ministre e Ekonomisë. Ai, duke prezantuar kërkesën, fillimisht paraqiti kronologjinë e marrëveshjes së energjisë me Serbinë. Më tutje, ai shtoi se me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes për kyçje KOSTT – ENTSO-E, përfshirë edhe fillimin e operimit të pavarur më 14 dhjetor 2020, si zonë rregulluese e pavarur, në kuadër të Bllokut Rregullues Kosovë – Shqipëri, KOSTT-i ka obligim ligjor dhe kontraktual, balancimin e Zonës Kontrolluese të Kosovës, në kufijtë energjetik, të cilët korrespondojnë me kufijtë gjeografikë të territorit të Republikës së Kosovës. Si pasojë e pezullimit të të hyrave për mbulimin e humbjeve për pjesën e veriut të Kosovës, KOSTT-i nuk ka pasur mundësi të prokurojë energji për mbulimin e humbjeve për pjesën veriore të Kosovës dhe nga data 2.12.2017, konsumi në pjesën e veriut të Kosovës është regjistruar si devijim i Kosovës ndaj sistemit të Evropës Kontinentale. Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes për kyçje KOSTT-ENTO-E, KOSTT, më datë 5.12.2020, ka filluar blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në veri të Kosovës, duke blere energji elektrike në tregun nacional dhe rajonal të energjisë elektrike, me buxhetin e ndarë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, KOSTT thjesht ka kryer një shërbim për llogari të Qeverisë së Kosovës. Në fillim të muajit prill 2021, KOSTT ka hyrë në fazë kritike në mungesë të mjeteve financiare për mbulimin e humbjeve për pjesën veriore. Të gjitha devijimet në Zonën Rregulluese të Kosovës, janë obligime financiare të KOSTT-it, të cilat do të paguhen në rast se ndodhin. Gjithashtu, KOSTT mund të gjobitet edhe me gjobë 5 milionë euro, në vit, sipas marrëveshjes, po ashtu duhet të kemi kujdes edhe me faktin se Marrëveshja KOSTT ENTSO-E është në mbikëqyrje të vazhdueshme dhe ne, nëse tregohemi jokorrekt dhe jo në harmoni me zotimet e dhëna, rrezikojmë edhe vet marrëveshjen me ENTSO-E. Andaj, kërkojmë përmes këtij komisioni që Kuvendi i Republikës së Kosovës, në koordinim me Qeverinë e Kosovës, të gjejnë një zgjidhje urgjente për të tejkaluar situatën e krijuar për mbulimin e humbjeve për muajt prill, maj dhe qershor 2021 apo deri në zgjidhjen e

qëndrueshme. Gjithashtu, në planin afatgjatë, të gjendet një zgjidhje apo të implementohet plani aksional, i cili i është propozuar Qeverisë së Kosovës dhe të lirohet KOSTT nga ky obligim i padrejtë dhe pa bazë ligjore.

**Artane Rizvanolli, ministre e Ekonomisë,** falënderoi komisionin për ftesën dhe për mundësinë për bashkëpunim dhe bashkëbisedim. Si ministri dhe Qeveri, sigurisht do të kemi një numër të sfidave, disa prej të cilave të trashëguara, për të cilat do të kemi nevojë për bashkëpunim të mëtejshëm dhe besoj që gjatë këtij mandati do të takohemi shpesh dhe do të kemi bashkëpunim të mirë. Çështja e energjisë në veri është e trashëguar që 20 vite, si problematikë. Është rritur konsumi në veri, vetëm 2019 dhe 2020 dhe ka arritur në 14%. Ky problem, sa është teknik është edhe politik. Çështja e energjisë në veri kërkon qasje strategjike dhe jo të ngutshme. Si zgjidhje është licencimi i një operatori në veri, sipas marrëveshjes. Plani aksional që u përmend nga kryesuesi i KOSTT-it, është në proces të analizimit nga ministria. Jemi duke punuar në një plan që do t'i jep zgjidhje këtij problemi, mirëpo zgjidhja kërkon kohë. Kjo periudhë tranzitore, derisa të gjendet zgjidhje, duhet të menaxhohet, sepse rrezikohet marrëveshja me ENTSO-E. Duhet angazhim i përbashkët edhe i Kuvendit si aksionar i KOSTT-it dhe të bëjmë zgjidhjen më të mirë.

**Kryetari** potencoi se nuk morëm përgjigje se Qeveria a do të paguajë këtë shumë prej 11 milionë eurove të kërkuara nga KOSTT-i. Nga 2018, ka rritje enorme të konsumit në veri, pse ka ndodhur kjo rritje e konsumit? A keni informacione, si Qeveri, se në veri është rritur konsumi i energjisë, për shkak se po zhvillohet industri ilegale e krijimit të kriptovalutave? Si do ta vendosni rregullin në veri për pagesën e rrymës? Kur institucionet e shtetit do ta zbatojnë ligjin dhe të mos paguhet nga taksat e qytetarëve të Kosovës rryma për qytetarët në veri? Sa i përket liberalizimit të tregut të energjisë dhe licencimit të furnizuesit në veri, a do të jetë ky operator që respekton ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës?

**Mimoza Kusari-Lila,** theksoi se problemi i energjisë në veri është problem i vjetër edhe është problem shtetëror. Ne nuk duhet të lejojmë që Kosova të identifikohet si problem në rrjetin energjetik evropian. Kosova tash ka subjektivitetin e vet si zonë e veçantë rregulluese e transmisionit të energjisë. Në vitin 2018 u bë rritja e madhe e konsumit në veri, a ka bërë në atë kohë ish- Qeveria ndonjë vlerësim pse ka pasur rritje të konsumit, ta sqarojë këtë KOSTT-i. A keni bërë ndarje mujore të pagesës, derisa të zgjidhet problemi i pagesës në veri? A është zgjidhje funksionalizimi i marrëveshjes së energjisë për veriun? Edhe sa kohë ka afat që Qeveria të mbulojë devijimet, që mos të ketë KOSTT-i sanksione dhe mos të rrezikohet marrëveshjen me ENTSO-E?

**Jeta Statovci,** theksoi se ky është problem i trashëguar ndër vite dhe duhet të angazhohemi të gjithë t'i japim zgjidhje, por sigurisht merr kohë. A mund ta sqaroni sa importohet energji dhe sa prodhohet në Kosovë?

**Pal Lekaj,** theksoi se duhet t'i qasemi problemit ashtu si është. Mendoj që shumica mund të veprojnë që të zgjidhë këtë problem dhe të ndalet diskriminimi. A do ta kompensoni energjinë e qytetarëve që kanë paguar për energjinë në veri? A do ta bëni pagesën për energjinë në veri apo do ta e ndërpreni?

**Uran Ismajli**, potencoi se nuk jemi duke bërë diskutim për historinë e problemit të energjisë. Nëse çështja është aq e rëndësishme duhet të diskutojmë për zgjidhjet e tanishme. Nëse paguhen prej buxhetit, atëherë nuk është trajtim i barabartë. A do ta paguani energjinë për veriun apo jo, nëse jo, cila është zgjidhja?

**Driton Hyseni**, theksoi se ky është problem që ka ardhur vit pas viti. A ka mundësi që KOSTT-i nga fitimi i vet të mbulojë koston e energjisë në veri?

**Valentina Bunjaku-Rexhepi**, pyeti: A keni ndonjë plan konkret për të dalë nga kjo situatë?

**Armend Muja**, pyeti: Sa ka qenë fitimi neto për 2020 i KOSTT-it? A keni shqyrtuar alternativa që të përdoren fonde tjera, siç është fondi për veriun?

**Ministrja Rizvanolli** sqaroi se Qeveria është duke punuar për zgjidhje afatgjate dhe trajtim të barabartë, por duhen muaj që të arrijmë të zgjidhja. KOSTT-i, shumë shpejt, do të përballet me ENTSO-E për barazim borxhi për devijimet nga rrjeti evropian i energjisë, dhe nëse nuk e kompenson, do të ketë sanksione nga ENTSO-E. Kostoja për energjinë e veriut është e madhe. Brenda buxhetit nuk ka mjete të destinuara, mirëpo Ministria e Financave është duke shikuar mënyrën, duke përfshirë edhe fondin për veriun. Informatat zyrtare të konsumit në veri janë këto shifra, që i patë. Ka indikacione që rritja e konsumit ka ardhur nga veprimtaria biznesore e ndoshta edhe nga krijimi i kriptovalutave. E theksoj, se është vërejtur që në veri konsumi energjisë nuk bie gjatë natës, ndërsa në pjesët tjera po. Jemi duke i parë mundësitë për ta rregulluar këtë çështje. Lidhur me liberalizimin e tregut, operatori ilegal në veri “Elektroserver” ka aplikuar së fundi në dhjetor 2020, për t’u licencuar për distribuim dhe furnizim. ZRRE-ja ka refuzuar aplikacionin për distribuim, ndërsa për furnizim, aplikimi është në shqyrtim.

**Mustafë Hasani, kryeshf i KOSTT-it**, potencoi se pavarësimi energjetik është bërë dhe ne e kemi marrë për detyrë që t’i përmbushim obligimet, në raport me ENTSO-E. Janë dy probleme: si të zgjidhet situatën aktuale dhe gjetjen e zgjidhjes afatgjate. KOSTT-i është ndërmarrje me funksionim shumë të mirë. Ne, si KOSTT, problemin e kemi ngritur tek aksionari. Blloku energjetik po ec mirë, por problem janë devijimet e energjisë nga rrjeti evropian. Është obligim për t’i kryer pagesat për devijimet, por edhe obligim kushtetues për të furnizuar qytetarët me energji. Ne ose duhet ta paguajmë energjinë e devijuar, ose duhet të blejmë energji dhe ta kompensojmë energjinë e devijuar. Pezullim të pagesës nuk mund të bëjmë. Varet se a duam ne të bëjmë pagesën tash apo me pritë me na vendosë edhe penallti për devijimet. ZRRE, me licencë, ka obliguar KOSTT-in të mbulojë humbjet në veri, mirëpo nuk ka vendosur për mënyrën e financimit. Ajo që kërkojmë prej komisionit është të përkrahet KOSTT-i, ta zgjidhë këtë çështje, për të ruajtur pavarësinë energjetike. Ne nuk mundemi të devijojmë energji elektrike edhe t’i themi Evropës se nuk po i marrim pagesat, sepse është çështje e brendshme për t’i marrë pagesat e konsumit të energjisë.

**Jeton Mehmeti, KOSTT**, sqaroi se gjatë vitit 2020, KOSTT-i ka 16 milionë euro fitim. KOSTT-i ka mjete për pagesë afatshkurtër. Neve na duhet leje nga aksionari për të paguar energjinë e devijuar me mjete të KOSTT-it. Aksionar është Kuvendi, pra jeni ju. Afati për pagesën e energjisë së devijuar nga rrjeti evropian energjetik ka kaluar më 7 prill. Ne është dashur të paguajmë ose të blejmë energji, për ta kompensuar atë që është devijuar. Rezervat

sekondare dhe terciare jemi duke i shfrytëzuar për balancim vetëm për këtë muaj, mirëpo na është tërhequr vërejtja nga Shqipëria, se rezervat nuk duhet të përdoren për këtë qëllim.

**Pal Lekaj**, theksoi se edhe javën e ardhshme kam thënë që, e keni mbështetjen time dhe të subjektit politik, për mos ta paguar rrymën për veriun. Është marrëveshja edhe duhet shikuar që të zbatohet. KOSTT-i nuk ka të drejtë të prokurojë rrymë, për të kompensuar devijimin. Ne e dimë problemin, e dimë marrëveshjen, pra kjo do zgjidhje të menjëhershme, por nuk pash ndonjë zgjidhje nga ministrja.

**Ministrja** sqaroi se planin e zgjidhjes nuk e kemi final, sepse duhet të jemi shumë të kujdesshëm. Ne, si institucione, duhet të jemi në një linjë për zgjidhjen politike dhe teknike afatgjate të këtij problemi.

**Driton Hyseni**, pyeti zyrtarët e KOSTT-it: A ju ka dhënë hapësirë ZRRE për mënyrën e financimit të energjisë në veri? Nga i gjithë ky problem nuk duhet përjashtuar edhe KESCO-n.

**Mustafë Hasani, KOSTT**, sqaroi se ZRRE-ja na ka dhënë obligim për energjinë në veri, por jo edhe të merren mjetet. KEDS-i ka distribucionin, kurse KESCO është vetëm furnizues. Kemi pasur takim me KEDS dhe KESCO, për t'i shikuar opsionet afatgjate. Tash duhet gjetur zgjidhjen për situatën aktuale.

**Ministrja** sqaroi se për çështjen e furnizuesit është një zgjidhje nga Marrëveshja e Brukselit, që ka të bëjë me licencimin e një operatori për veriun. Ky furnizues ka aplikuar në ZRRE, por dokumentet e aplikimit kanë qenë me emërtime, në kundërshtim me Kushtetutën. Hapat e ardhshëm janë që KEDS-i të kontraktojë kompaninë lokale, në veri, që ta bëjë inkasimin në veri.

**Uran Ismaili**, potencoi se KOSTT-i është në një situatë kur duhet paguar rrymën për disa qytetarë në veri, që nuk e paguajnë. Nuk duhet të ketë diskriminim. Nëse e paguan, Qeveria përsëri i bie që po e paguajnë qytetarët, të paguajë KOSTT-i nga të hyrat e veta, humbin mjetet për investime në rrjet. A e keni problemin e vullnetit politik apo nuk po keni ku t'i merrni paratë? Nuk po shoh qëndrim të ministres për zgjidhje kreative. Nuk po ka vullnet politik për ta zgjidhur këtë problem.

**Mimoza Kusari-Lila**, theksoi se është Marrëveshja për energji, që është nënshkruar në Bruksel, që një kompani në veri të licencohet. Por tash as ZRRE-ja nuk mund të lëshojë licencë, sepse nuk ka bord. Ne kërkojmë prej Qeverisë që Bordi i ZRRE-së, të propozohet dhe të zgjidhet. Bordi, mandej të gjejë mënyrën për ta licencuar kompaninë, në veri. Ne t'i japim Qeverisë afatin kohor, të zgjedhë bordin dhe të shohim mundësinë që të paguajë muaj për muaj.

**Valentina Bunjaku-Rexhepi**, theksoi se Lëvizja Vetëvendosje ka ardhur në pushtet, duke thënë se nuk do ta paguajmë rrymën për veriun. Kërkoj që ta bëni një plan, si Qeveri, dhe t'i jepni zgjidhje. Marrëveshja e Brukselit është që disa vite.

**Jeta Statovci**, pyeti: Cili institucion është prijës i planit aksional për këtë problematikë dhe si do të përfshihen palët tjera?

**Ministrja** potencoi se ky problem sa është teknik, është edhe politik. Për këtë arsye, kjo problematikë është që 20 vjet. Ne, si Qeveri, mendojmë që secili që konsumon duhet të paguajë energji elektrike. Ne u munduam të shpjegojmë situatën politike edhe teknike aktuale. Po themi që ose duhet ta paguajmë tash, ose mandej, plus penalltitë. Sa i përket pagesës, Ministria e Financave është duke shikuar mundësitë që pagesa të mos bëhet me mjete të qytetarëve taksapagues. Opcion është që pagesa të bëhet edhe me mjete të KOSTT-it, por Kuvendi si aksionar duhet të vendosë.

**Uran Ismaili**, theksoi se edhe kjo Qeveri po dëshiron, si të tjerat, t'ua paguajë rrymën qytetarëve të veriut. Nuk po më duket qëndrim i mirë të paguajë rrymë Qeveria për veriun.

**Armend Muja**, theksoi se parimisht jam kundër pagesave të çfarëdo forme për energjinë në veri. Duhet plan afatshkurtër për pagesën aktuale. Ne jemi të gatshëm të kontribuojmë për planin aksional, për të dalë prej kësaj situatë dhe duhet shikuar edhe fondin për veriun, që të përdoret.

**Kryetari** theksoi se ne si aksionarë të KOSTT-it, ju themi që të keni kujdes në respektimin e ligjit, sa i përket pagesave.

***Komisioni e ndërpreu mbledhjen, për shkak të seancës plenare, që do të fillojë në orën 15:00 dhe vendosi që mbledhja të vazhdojë të nesërmen, më 28.4.2021, në orën 13:30.***

\* \* \*

**Vazhdimi i mbledhjes, më datë 28.4.2021, ora 13:30.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ferat Shala, kryetar, Jeta Statovci, nënkryetare e parë, Fidan Jilta, nënkryetare e dytë, Gramoz Agusholli, Driton Hyseni, Mimoza Kusari – Lila, Armend Muja, Uran Ismaili, Ljubinko Karaxhiq dhe Pal Lekaj, anëtarë.

**Mungoi:** Valentina Bunjaku-Rexhepi, anëtare.

**Të ftuar:** znj. Artane Rozvanolli, ministre e Ekonomisë;  
z. Isuf Mehmeti, Kosova Thëngjilli Sh.A.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Anyla Beqa, Ministria e Ekonomisë; Agim Grajçevci, Ferki Hyseni dhe Muhamed Ahmeti – Kosova Thëngjilli sh.a.; Ferid Pula dhe Besianë Musmurati – GP/PDK; Bjondina Çanta – Kuvendi dhe mediat.

**Kryetari** kërkoi mirëkuptim, pasi që është ministrja duke pritur për kërkesën e ndërmarrjes “Kosova “Thëngjilli Sh.A.”, ta kryejmë një herë këtë pikë e mandej t’i nxjerrim rekomandimet për kërkesën e KOSTT-it.

*Komisioni përkrahu propozimin e kryetarit.*

#### **4. Shqyrtimi i kërkesës së ndërmarrjes “Kosova Thëngjilli SH.A”, të ftuar për raportim: ministrja e Ekonomisë, znj. Artane Rizvanolli; Bordi dhe menaxhmenti i ndërmarrjes “Kosova Thëngjilli SH.A”**

**Kryetari** potencoi se edhe në këtë pikë kemi një kërkesë nga kompania “Kosova Thëngjilli SH.A” dhe i ftoi përfaqësuesit e ndërmarrjes “Kosova Thëngjilli SH.A”, që ta paraqesin kërkesën, në pika të shkurta, dhe mandej ministrja opinionin e Qeverisë.

**Isuf Mehmeti, “Kosova Thëngjilli SH.A”**, sqaroi se nga 1 janari 2021, kur ka hyrë në fuqi Ligji për rimëkëmbje ekonomike, ne kemi tentuar të lirohemi prej rentës minerare në kontratën me KEK-un, prej të cilës furnizohemi me thëngjill. Kërkesa jonë është ta marrim një përgjigje, se a kemi të drejtë të lirohemi nga renta minerare. Kompania “Kosova Thëngjilli SH.A” ka rreth 200 punëtorë. Ne kemi kërkuar nga KEK-u, që sipas ligjit dhe kontratës, të lirohemi nga taksa e rentës minerare, mirëpo KEK-u nuk përgjigjet. Nga 1 janari 201 “Sharrçemi” dhe “Ferronikeli” nuk blejnë prej neve thëngjill pa i liruara nga renta minerare. Jemi të dëmtuar, si kompani, për shkak të mos lirimit nga renta minerare.

**Ministrja** sqaroi se ne si ministri e kemi trajtuar këtë rast me njësinë për monitorim të ndërmarrjeve publike dhe me zyrën ligjore të ministrisë. Sipas mendimit të zyrës ligjore, kompania “Kosova Thëngjilli SH.A” duhet të paguajë rentën minerare, sipas kontratës. Unë mendoj që kompania “Kosova Thëngjilli SH.A” duhet të lirohet nga renta minerare, sepse ndryshe nuk ka logjikë ekonomike.

**Kryetari** theksoi se KEK-u, padrejtësisht, po e vjel rentën minerare nga kompania “Kosova Thëngjilli SH.A”, për të cilën është liruara me ligj. Nuk duhet të lejojmë KEK-un që në rrethana pandemie të bëjë diskriminim ndaj kontraktorit. A mund të dimë, cili do të jetë hapi ardhshëm i ministrisë? KEK-u nuk është duke e furnizuar “Kosova Thëngjillin”, kur zgjidhet ky problem? KEK-u po i shet kompanisë së Maqedonisë thëngjill, më lirë se kompanisë “Kosova Thëngjilli”, pse po ndodh kjo, a keni informacione? A keni ndonjë alternativë në zgjidhjen e këtij problemi? Ju kompania “Kosova Thëngjilli SH.A”, a keni ndonjë plan?

**Ministrja** sqaroi se nuk i kam informatat për të gjitha kontratat. Ne, përmes njësisë dhe bordeve komunikojmë me KEK-un. Ne jemi në një situatë kur kemi mendimin ligjor të zyrës ligjore. Po e përsëris që mendimi im është që të lirohet nga renta minerare “Kosova Thëngjilli SH.A”. Ne nuk mund ta detyrojmë KEK-un, sepse ndërhyrja në kontrata do të ishte ndërhyrje në mikromenaxhim. Ne, përmes komunikimeve me njësinë dhe bordin, do të mundohemi të vijmë te zgjidhja. Me mendimin ligjor, zyra ligjore e ministrisë po thotë se nuk është shkelur ligji, por sipas mendimit tim, nuk ka logjikë ekonomike interpretimi i zyrës ligjore

**Mimoza Kusari-Lila** theksoi se Qeveria si aksionar ushtron të drejtën e aksionarit dhe të vendosë. Mendoj që nuk ka logjikë që KEK-u të lirohet nga renta minerare e kontraktorit të ja marrë rentën minerare. Është në kompetencë të Qeverisë me zgjidhë këtë çështje. Qeveria e ka të drejtën e plotë ta obligojë KEK-un ta lirojë “Kosova Thëngjilli SH.A” nga renta minerare.

**Armend Muja** potencoi se Kuvendi nuk ka çka jep më shumë, Kuvendi e ka bërë ligjin edhe në rregull është. Çfarë ndërmarrje është “Kosova Thëngjilli SH.A”, pra ju jeni shoqëri aksionare

dhe jo ndërmarrje publike dhe nuk aplikohet ndaj juve Ligji për ndërmarrjet publike. Andaj, duhet edhe të konsultoheni me ministrin e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

**Uran Ismaili**, theksoi se ne si komision e kemi të qartë. Ligji është i barabartë për të gjithë. Ka pasur pasivitet atje, në ministri, në trajtimin e kësaj kërkesë. Qeveria është dashur të përfundojë këtë çështje. Ju si ministre nuk duhet të ndaleni vetëm te mendimi i zyrës ligjore.

**Pal Lekaj**, potencoi se askush nuk mund ta zbatojë ndryshe ligjin. Ligji është i qartë, nuk ka dilema. Nuk po e kuptoj, ku është bazuar zyra ligjore për këtë mendim. Bordi i KEK-ut i përgjigjet Qeverisë, nëse kanë bërë shkelje, duhet ndaluar. Të kërkonte te Qeveria, që të marrë vendim për zbatim të ligjit nga KEK-u.

**Mimoza Kusari-Lila**, theksoi se nëse mendoni se ka dumping në këtë çështje, duhet të dërgoni ju kërkesë në ministri për Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, sepse ministria nuk nis hetimet “ex-officio”.

**Jeta Statovci**, theksoi se sipas ligjit të gjitha subjektet që obligohen për këtë rentë minerare janë të lira. Pas kërkesave në ministri, që kanë bërë, janë udhëzuar për në Kuvend. Pas diskutimeve, këtu shihet se ka një konsensus, që kjo çështje të zgjidhet në kuadër të Qeverisë.

**Kryetari** potencoi se kjo temë është e Qeverisë, që ta zgjidhë, për neve është shkelje ligjore nga KEK-u.

*Pas debatit, komisioni nxori këtë:*

#### *P e r f u n d i m*

*Kërkesa e ndërmarrjes “Kosova Thëngjilli SH.A” për lirim nga renta minerare në kontratën me KEK-un për furnizim me thëngjill, të zgjidhet në kuadër të Qeverisë dhe organeve të saj.*

**Lidhur më rekomandimet për KOSTT, kryetari** tha se debati për kërkesën e KOSTT-it, lidhur me pagesën e energjisë, në veri, është shterur. Aktualisht, kemi dy draft-propozim-rekomandime të dorëzuara me shkrim. Pra, rekomandimet e mia dhe rekomandimet e deputetes Mimoza Kusari-Lila dhe kërkoi që stafi t’iu shpërndajë rekomandimet anëtarëve të komisionit. *Rekomandimet e dorëzuara me shkrim nga kryetari i komisionit Ferat Shala, janë: 1. NP KOSTT, duhet të paraqesë para Komisionit funksional, në baza mujore, devijimet e energjisë elektrike në veri të vendit, nga data 1 janar deri më 30 qershor 2021, me qartësim ligjor dhe financiar të pagesave; 2. Autorizohet NP KOSTT, që ta përcjellë situatën dhe njëkohësisht ta informojë ministrin e Ekonomisë, për devijimet energjisë elektrike në veri të vendit; 3. NP KOSTT nuk guxon të lëkundë stabilitetin e tij financiar, në emër të pagesave për shpenzuesit ilegalë në pjesën e veriut të vendit; 4. Qeveria e Kosovës – respektivisht Ministria e Ekonomisë, brenda afatit 30 ditorë, të paraqes në Komision funksional, planin final të zgjidhjes së këtij problemi; 5. Obligohet Qeveria e Kosovës për një periudhë 3 (tre) mujore, që të krijojë kushte dhe të shtrijë autoritetin, që të mundësohet inkasimi i rregullt i energjisë elektrike në veri të vendit.*



*Rekomandimet e dorëzuara me shkrim nga deputetja Mimoza Kusari-Lila janë: 1. NP KOSTT, duhet të paraqesë para Komisionit funksional, në baza mujore, devijimet e energjisë elektrike në këto komuna: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, për 6 (gjashtë) muajt e ardhshëm, duke filluar nga muaji prill 2021; 2. NP KOSTT, të paraqesë në Komision funksional, shpenzimet e energjisë elektrike, në baza mujore retroaktivisht, prej 1 janar 2018 – deri më 1 prill 2021; 3. NP KOSTT, duhet të paraqesë në Komision funksional, zgjidhjen mujore për devijimin e energjisë elektrike në katër komunat e Kosovës (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan); 4. Autorizohet NP KOSTT të mbulojë devijimet e energjisë elektrike në katër komunat e vendit (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan), sipas zgjidhjes së prezantuar dhe miratuar në Komisionin funksional, duke shfrytëzuar të hyrat nga buxheti vetanak, mjete këto të cilat do të kompensohen nga dividendat apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm; 5. Obligohet Qeveria e Kosovës, që brenda afatit 6 (gjashtë) muaj, të sigurojë të gjithë procesin e futjes në sistemin e faturimit sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi, në bashkëpunim me palët përgjegjëse për faturimin e konsumatorëve, në katër komunat e Kosovës (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan), me energji elektrike.*

**Jeta Statovci**, theksoi se është edhe një rekomandim nga deputetja Valentina Bunjaku, që ka dërguar në grup të komunikimit.

**Kryetari**, duke iu referuar rekomandimeve, theksoi se dallimi mes rekomandimeve të deputetes Mimoza Kusari dhe të miave, janë mes asaj që Qeveria abrogohet, sipas mendimit tim, me rekomandimet e deputetes Kusari, sepse e tërë barra dhe pesha mbetet në KOSTT. Ndërsa, unë mendoj që Qeveria, si institucioni më i lartë ekzekutiv dhe garantues për marrëveshjet e deritanishme, duhet të ketë rolin e vet. KOSTT nuk ka asnjë marrëveshje të ndërlidhur me pagesën e energjisë në veri. Në këtë rast, konsideroj se ne si komision, si deputetë, nuk mund ta lirojmë Qeverinë nga përgjegjësia direkte, që ka në zbatimin e marrëveshjeve dhe në monitorimin e zbatimit të tyre. Ne duhet ta ruajmë pavarësinë financiare të KOSTT-it dhe barra e përgjegjësive financiare dhe politike duhet t'i takojë Qeverisë. Unë i kam shtruar rekomandimet e mia, duke ruajtur çështjen që Qeveria është autoriteti i vetëm që mund të marrë përgjegjësi për zbatimin e marrëveshjeve. Konsideroj se ne duhet t'i drejtohem Qeverisë, ashtu siç i kam shkruar rekomandimet dhe Qeveria pastaj i ka duart e lira në përgatitjen e planit për zbatimin e ligjshmërisë dhe shtrirjen e autoritetit në tërë territorin e vet. KOSTT nuk ka asnjë mundësi as të planifikojë e as të zbatojë, pa mbështetjen e institucioneve qeveritare.

**Mimoza Kusari-Lila**, theksoi se Qeveria ka obligimet e veta, edhe me propozim-rekomandimet e mia, obligohet Qeveria, por një e cila është shumëdimensionale, sepse problemet e veriut nuk janë të djeshme, por janë të 21 viteve. KOSTT-i, si ndërmarrje publike është e vetmja që e ka kuvendin si aksionar, për dallim prej ndërmarrjeve tjera ku aksionare është Qeveria. Neve na takon që drejtpërdrejt me KOSTT-in, të vijmë te një zgjidhje e menjëhershme. Arsyeja që kam propozuar që KOSTT-i, e para të tregojë mbi baza mujore për devijimin e rrymës dhe të tregojë edhe alternativat që mund të bëhen me blerje të rrymës. Nëse ne autorizojmë KOSTT-in, që në periudhë gjashtëmujore të marrë përgjegjësinë e obligimeve nga devijimi i rrymës dhe të kontraktojë blerjen e rrymës, për të kompensuar devijimin, i bie shumë më lirë sesa të paguajë Qeveria për devijimet mbi baza mujore të bëjë kompensimin. Në ndërkohë, Qeveria intensivisht merret me mbikëqyrjen e licencimit nga ZRRE-ja për një kompani që duhet të bëjë furnizimin dhe faturimin në këto katër komuna në pjesën veriore dhe

me sigurinë dhe problemet tjera, që janë aktuale në veri. Ne, tash e kemi situatën edhe kur duhet ta ruajmë subjektivitetin tonë, si shtet, në raport me ENTSO-E, si dhe obligimet që i kemi në raport me berzen e energjisë me Shqipërinë.

**Kryetari** theksoi se, në parim, ne nuk duhet të rrezikojmë stabilitetin financiar të KOSTT-it, për shkak të marrëveshjeve ndërkombëtare që bënë Qeveria. Konsideroj që rekomandimet e mia do ta obligonin Qeverinë që ta fusë në prioritet. Edhe ne e kemi paraparë që brenda tre muajsh, nga miratimi i rekomandimeve në Kuvend, Qeveria ka kohë të mjaftueshme të programojë edhe planin afatshkurtër dhe afatgjatë. Konsideroj se gjashtë muaj janë shumë. KOSTT-i këtu është një lloj viktime. Është përgjegjësi direkte e Qeverisë.

**Armend Muja**, theksoi se realisht, marrë parasysh edhe ZRRE-në, që i duhet kohë për ta licencuar, edhe ne konsiderojmë se afati gjashtë muaj është optimal. Sa i përket Qeverisë, ne nuk e autorizojmë Qeverinë të paguajë prej taksave tona, sepse edhe nuk ka paraparë buxhet për këtë destinim. Por, për gjashtë muaj, mund të trajtohet më përmbytësisht ndonjë zgjidhje. Propozoj që propozim-rekomandimet e deputetes Kusari, të dalin në votim.

**Uran Ismaili**, theksoi se KOSTT-i ka kërkuar 11 milionë euro, që mos të rrezikohet stabiliteti financiar. Propozimi i deputetes Mimoza Kusari, në dy pika, e rrezikon stabilitetin financiar të KOSTT-it. Deputetët nuk duhet me marrë përgjegjësinë, për të obliguar KOSTT-in t'ua paguajë me mjete të tyre pagesën për devijimin e energjisë. Propozimi është i dëmshëm, është porosi e keqe për veriun, vazhdoni mos paguni energjinë. Ne, me votën tonë, sikur po duam ta miratojmë hajninë me rrymë.

**Driton Hyseni**, potencoi se dje dëgjuam nga KOSTT-i, se duan të qëndrojnë besnik ndaj marrëveshjes me ENTSO-E dhe ta ruajmë pavarësinë tonë energjetike brenda rrjetit evropian. KOSTT-i ka fitim dhe ndoshta për disa muaj e ka mundësinë të mbulojë devijimin. Mendoj që kishim mundur të rekomandojmë që në planin aksional ta kemi edhe një pikë prerje, ku rryma e shpenzuar në veri të regjistrohet dhe ajo në mënyrë retroaktive të kthehet, kur pjesa e veriut të integrohet në sistem energjetik.

**Pal Lekaj**, theksoi se kemi shtetur debatin dhe duhet të pajtohemi që shteti ka obligime me marrëveshje dhe nuk mund t'i ikim. Ne kemi përgjegjësinë që mos ta vazhdojmë atë të keqe që është deri sot. Unë nuk pajtohem, që ta ngarkojmë KOSTT-in, me 11 milionë euro. Kjo nuk ka kuptim. Duhet që, Qeveria për 90 ditë, të kryejë detyrat në tërë territorin e Kosovës.

**Jeta Statovci**, theksoi se nga deklaratimet e KOSTT-it, dje deklaruan se vitin paraprak ka pasur rreth 23 milionë euro fitim, si dhe për vitin 2020 kanë pasur fitim neto 16 milionë. Në bazë të deklaratimeve të tyre, ata mund ta mbulojnë këtë kosto, pa i rrezikuar parametrat financiarë. E nëse ka rrezikim financiar, po shoh se te pika katër, lë mundësi që të kompensohet edhe nga dividenda, duke qenë aksionar Kuvendi apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm. Deri në një parametër që nuk rrezikon stabilitetin financiar, të mbulohet nga të hyrat buxhetore të KOSTT-it.

*Pas debatit, komisioni, me 6 (gjashtë) vota për, 3 (tri) kundër dhe asnjë abstenim, nxori këtë:*

### *Rekomandim*

- 1. Miratohen propozim-rekomandimet e deputetes Mimoza Kusari-Lila, në lidhje me kërkesën e NP KOSTT, për sigurimin e mjeteve financiare për mbulimin e humbjeve në pjesën veriore të Kosovës;*
- 2. Raporti me rekomandime i procedohet Kuvendit për shqyrtim.*

### **5. Diskutim lidhur me funksionim e agjencive të pavarura, që i raportojnë komisionit**

**Kryetari** theksoi se e keni marrë një material nga stafi, ku është paraqitur një tabelë, ku i keni të dhënat për secilën agjenci. Por, duhet ta kemi parasysh se disa pozita duhet t'i propozojë Qeveria dhe për disa duhet komisioni të hapë konkurs. Andaj, duhet t'i dërgojmë letër Kryetarit dhe Kryesisë së Kuvendit, që të kërkojë nga Qeveria, që të shpallë konkursin sipas ligjit ose të procedojë propozimet, për Bordin e ZRRE-së; për Bordin e KPMM-së; për Bordin e ARKEP-it; për Bordin e AKK-së; si dhe për një pozitë për minoritar për Bordin e NP KOSTT. Ndërsa, ne duhet të hapim konkursin për drejtorin e ARRU-së dhe për kryesuesin që merret me shqyrtimin e ankesave në ARRU.

*Pas sqarimit nga kryetari, komisioni vendosi si në vijim:*

- 1. Komisioni, përmes Kryetarit/Kryesisë së Kuvendit të kërkohet nga Qeveria përshpejtimin e procesit të zgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të bordeve të agjencive të pavarura në pozitat vakante dhe t'i propozojë Kuvendit kandidatët për emërim;*
- 2. Të shpallet konkursi për zgjedhjen e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit – ARRU dhe konkursi për zgjedhjen e drejtorit të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit – ARRU.*

### **6. Të ndryshme**

#### **a) Njoftim për takim me odat ekonomike dhe me organizata tjera**

**Kryetari** theksoi se siç iu kam njoftuar në mbledhjen e kaluar, me nënkryetaren jemi takuar javën e kaluar me disa nga odat ekonomike dhe asociacionet tjera, pra për një takim njoftues, ndërsa nesër do të takohemi me organizata tjera, nëse jeni të interesuar, mund të vini në takim.

#### **b) Njoftim për organizimin e vizitës në KPMM**

**Kryetari** njoftoi se lidhur me kërkesën e deputetëve për vizitë në KPMM, pas kontaktit të stafit me drejtorin e KPMM-së, ka mbetur që javën e ardhme të bëjmë vizitën. Pra, ju lutem cilën datë mendoni ta vizitohet KPMM-në?

**Armend Muja**, theksoi se do të koordinohemi në grupin komunikues, për kohën e përshtatshme.

**Mbledhja përfundoi në orën 16:00.**

**E përgatiti: Staf mbështetës i komisionit**

**Kryetar i komisionit,**

-----  
**Ferat Shala**